



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-15290 /26

Klinë, dt: 04.06 /26

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 10.04.2026, me fillim nga ora 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Enver Berisha, i cili përshëndeti nënkryetarin e komunës, z. Fadil Gashi, drejtorët e drejtorive, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të gjithë të pranishmit .

Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsytimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e KPF-së;
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-mars 2026;
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa mars-prill 2026;
5. Të ndryshme.

Enver Berisha, kryesues: Përshëndetje dhe mirë se erdhët në mbledhjen e KPF-së.

Prezent janë të gjithë. Unë e falënderoj nënkryetarin e komunës që e ndau kohën për të qenë sot me ne, drejtorët e drejtorive. Besoj që rendin e ditës e keni marrë me kohë, si dhe materialet e tjera që është dashur t'i keni. Po ashtu, besoj që pengesa lidhur me dërgimin e materialeve po eliminohet në tërësi dhe mendoj që ju kemi pajisur me kohë. Fillimisht, sa i përket rendit të ditës, a ka dikush diçka që mendon se është mirë të futet në këtë rend dite apo vazhdojmë me këtë rend dite që e kemi para vetes? Urdhëro, z. Esat Raci.

Esat Raci: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Te pika 4 e rendit të ditës, te shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa, dy qytetarë kanë pyetur për një kërkesë që e kanë bërë para 2-3 ditësh për rrugën “Azem Desku”. A ka mbërritur në këtë komitet?

Enver Berisha, kryesues: Jo, s’ka mbërritur në këtë komitet, për shkak se materiali është dërguar më vonë. Besoj në seancën tjetër. Dikush tjetër? Nëse jo, atëherë a jeni për këtë rend dite?

Me 7 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Enver Berisha, kryesues: Te arsyetimi i mungesave, të gjithë jemi prezentë.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e KPF-së.

Enver Berisha, kryesues: A ka dikush diçka për të shtuar rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë kush jeni për aprovimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar?

Me 7 vota PËR, u miratua procesverbali i KPF-së nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-mars 2026.

Enver Berisha, kryesues: Para se t’ia jap fjalën drejtorit, jam i vetëdijshëm se për tri vjet kam qenë udhëheqës i kësaj drejtorie. Kësaj here është pak më specifike, siç vërehet edhe në raport. Janë dy çështje më thelbësore që kanë ndodhur, që ndoshta raporti ka mundur të jetë ndryshe dhe më i kompletuar. E para është se buxheti i shtetit është aprovuar me vonesë dhe ndarja nëpër komuna është bërë gjithashtu me vonesë, gjë që ka kufizuar punën e komunave. E dyta është se faturat e tatimit në pronë, që zakonisht lëshohen në shkurt, kësaj here janë lëshuar vetëm në

Kërkesa 2. Kërkesë për rivlerësimin e kategorizimit nga profesional 3 në profesional 2. Përmes kësaj kërkesë, të parashtruar nga udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile, z. Muhamet Gashi, kërkon rivlerësimin e kategorizimit nga niveli profesional 3 në profesional 2 për zyrtarët e gjendjes civile në Komunën e Klinës, si në vijim:

- Ramiz Zeqa – Zyrtar i Gjendjes Civile, Grabanicë
- Anton Përlaska – Zyrtar i Gjendjes Civile, Zllakuqan
- Rrahman Morina – Zyrtar i Gjendjes Civile, Sferkë

Enver Berisha, kryesues: Dhe është një kërkesë pak më specifike, kërkesë e tre ofiqarëve, të cilëve koeficienti nuk u ka mundësuar të rritet kur ka ndodhur ngritja e koeficienteve për të tjerët. Tash këto dallime në mes të kualifikimeve dhe të gjërave që ata i kanë përmbushur ende nuk janë përmirësuar. Z. Arben Limani e ka ngritur edhe në seancën e kaluar këtë çështje, mirëpo duke u bazuar në natyrën e problemit, nuk është çështje e asamblesë komunale. Ne mund ta rekomandojmë këtë çështje në Zyrën e Personelit dhe drejtoria, në fakt, të shohë se si të gjendet zgjidhja për këta tre ofiqarë, të cilëve realisht nuk u është bërë zgjidhja për ngritjen e koeficientit. A ka dikush për debat, a pajtoheni?

Esat Raci: Kryesues, faleminderit. Realisht, për këtë pikë, për këtë kërkesë të këtyre tre zyrtarëve është dashur drejtori i Administratës të jetë këtu, por nuk është. Kam parë kërkesën e tyre dhe, për mendimin tim, është e arsyeshme. Nëse ka laramani për vëllim të njëjtë të punës, u është bërë e padrejtë. Bisedoni me organin përgjegjës të personelit apo burimeve njerëzore, kushdo që është ai. Me siguri ekzekutivi e di. Kështu që të merret seriozisht kjo kërkesë e këtyre tre zyrtarëve. Njëri veç ka dalë në pension tash, sipas informacioneve që kam. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Dikush tjetër? Valmir Baca e ka fjalën.

Valmir Baca: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Këtë çështje e kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar. Drejtori i Administratës e ka dhënë shpjegimin për këtë çështje dhe asambleja nuk është organ kompetent për t'i shqyrtuar këto kërkesa. Kështu që edhe ne pajtohemi që ky rekomandim të kalojë në Drejtorinë e Administratës dhe të shihen mundësitë. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Valmir. Dikush tjetër? Nëse jo, atëherë kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile, z. Muhamet Gashi, për rikategorizimin e koeficientit nga profesional 3 në profesional 2, me 7 vota PËR, rekomandoi që fillimisht kërkesa të shqyrtohet në Kuvend dhe më pas të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Administratë dhe Zyrën e Personelit në Komunën e Klinës.

Pika 5. Të ndryshme.

Enver Berisha, kryesues: A ka dikush te të ndryshme?

Teuta Mulaj: Te pika e katërt, nëse mundem me e paraqit edhe te pjesa e të ndryshmeve, është kërkesa e banorëve që do të vijnë me datën 30.04.2026. Për kuvendin komunal, komunën dhe kryetarin nuk është diçka e panjohur. Po flas konkretisht për lagjen “Azem Desku”. Jeni njoftuar prej vitit 2024. Kërkoj që në seancën tjetër të jetë pjesë e rendit të ditës, sepse është në interes të banorëve. Ata kanë bërë kërkesa të njëpasnjëshme. Ne kemi të drejtë edhe sot të propozojmë që të jetë në rend dite në seancën tjetër. Nuk e kam të qartë pse po shtyhet vazhdimisht, kur neve si banorë po na pengon fakti që po zhvillohen punime që nuk po na lejojnë të kthejmë rrugën ekzistuese që e kemi pasur për 60 vite. E kemi pas edhe një premtim nga kryetari që do ta shikojë gjendjen.

Enver Berisha, kryesues: Në kuvend kjo temë është trajtuar dhe është shtjelluar. Është çështje e ekzekutivit dhe e kryetarit, të cilët kanë marrë obligim të dalin në terren, ta vizitojnë rrugën dhe të marrin masat e nevojshme.

Teuta Mulaj: Ne kemi biseduar edhe me ministrinë përkatëse, prandaj është e nevojshme të jetë edhe në seancën e ardhshme. Ata thonë që i takon komunës vetëm të bëjë një kërkesë që rruga të kthehet në pronë publike. Nuk është diçka që ju kushton shumë. Kam pritur nga kryetari dhe drejtoritë përkatëse të dalin dhe ta shohin gjendjen. Rruga është vërtet e pakalueshme dhe e vështirë, edhe për shkak të pjerrtësisë. Prandaj kërkoj një veprim të menjëhershëm dhe këmbëngul që të jetë në seancën e ardhshme.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Teuta. Para se t'ia jap fjalën nënkryetarit, po e përsëris që kjo temë është trajtuar në asamble dhe Drejtoria e Urbanizmit bashkë me kryetarin kanë marrë obligim ta shohin në vend ngjarjen dhe të marrin masa. Nëse edhe niveli ministror është i interesuar të ndërhyjë, kjo është edhe më mirë. Ne do ta vizitojmë edhe njëherë para seancës dhe, nëse është e nevojshme, do ta procedojmë përsëri në asamble. Urdhëro, nënkryetar.

Fadil Gashi, nënkryetar: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Nëse mundem pak më në detaje: ne kemi praktikë, e cila është edhe ligjore edhe procedurale, që çështjet që trajtohen në seancë dhe marrin epilog nga seanca, nuk trajtohen dy herë. Por problemi qëndron se ajo nuk është pronë e komunës. Këtu është thelbi, sepse aty ka probleme me hekurudhën, pra me pronat, jo me rrugën si rrugë, por me pronësinë. Nëse ka ndërhyrë niveli qendror, është mirë. Madje insistoj edhe te ju që të përdorni autoritetin tuaj që ata të ndërhyjnë, sepse te bordi i hekurudhave vetëm ata mund të ndërhyjnë. Në këtë rast, ajo është pronë e hekurudhës dhe për një orë bordi i hekurudhave mund ta zgjidhë këtë problem. Nuk ka nevojë të vihet në telashe as komuna, as banorët. Ata po ia kalojnë përgjegjësinë komunës, por nuk është pronë e jona që ne të mund të ndërhyjmë, as të vendosim shenja, as të ndalojmë diçka. Pëlqimet i kanë marrë nga ata, jo nga komuna. Prandaj, në këtë rast, niveli qendror e ndihmon komunën dhe e lehtëson këtë

proces, nëse ndërhyr drejtpërdrejt përmes hekurudhës. Sepse, në fund të fundit, vetë ata kanë dhënë pëlqim. Mjafton të lexohen shkresat që i ka lëshuar vetë bordi.

Unë ju lus edhe njëherë: çfarë mund të bëni për seancën e radhës, është mirë ta ruani këtë çështje, ta rezervoni dhe të pyesni kryetarin e komunës deri ku ka arritur kjo situatë. Kjo do të ishte më e mira, që në seancë të shtrohet si pyetje se deri ku ka arritur dhe cila është rruga që po ndiqet për zgjidhjen e saj. Si pikë e veçantë, kjo çështje është trajtuar dhe është përmbyllur në kuvend. Kjo nuk do të thotë që, nëse nesër Zyra e Kryetarit ka nevojë, nuk mund të rikthehet përsëri në kuvend, por jo në këtë formë.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit. Arben Limani e ka fjalën.

Arben Limani: Përshëndetje për të gjithë. Edhe unë e kam marrë këtë shqetësim të banorëve, pra më është prezantuar nga banorët e asaj lagjeje si një problem ende i pazgjidhur. Ne e kemi pasur këtë çështje edhe si temë diskutimi në seancën e asamblesë, mirëpo unë besoj që banorët kanë të drejtë ta paraqesin si kërkesë, sidomos kur nuk shohin që ekzekutivi po merret në mënyrë të mjaftueshme me të. Kjo çështje po përsëritet në vazhdimësi dhe, nëse ekzekutivi është duke u marrë me të, atëherë është në rregull që kryetari të na prezantojë se cilët hapa janë ndërmarrë deri më tani për realizimin ose përfundimin e këtij projekti. Siç ma ka prezantuar një nga banorët e lagjes, nëse bëhet fjalë për pronë të hekurudhave, atëherë komuna duhet të bëjë një kërkesë në bordin e hekurudhave që ajo pronë të jepet në shfrytëzim, në mënyrë që pastaj komuna të mund të ndërhyjë dhe ta zgjidhë problemin. Përderisa banorët e lagjes thonë se e kanë të pamundur të qarkullojnë në atë rrugë, atëherë kjo tregon që problemi është më i madh sesa vetëm një kërkesë e thjeshtë administrative. Andaj, mendoj që do të ishte mirë që kjo çështje të trajtohet, qoftë përmes një pyetjeje nga ne drejtuar kryetarit, drejtorit të urbanizmit apo dikujt nga ekzekutivi, apo edhe si pikë diskutimi, përderisa shqetësimi i banorëve është i vazhdueshëm. Ne e dimë që prezantimi i kërkesës ka qenë i gjatë dhe i detajuar, prandaj është me rëndësi të shihet se ku ka mbërritur puna deri më tani. Sipas informatave që kam marrë, me një kërkesë të komunës, bordi i hekurudhave apo institucioni përkatës mund ta japë atë hapësirë në shfrytëzim, qoftë për komunën apo për banorët. Ndoshta edhe Zyra Ligjore mund të japë një sqarim më të detajuar se si definohet kjo çështje nga aspekti juridik. Megjithatë, mbi të gjitha, është e rëndësishme që problemi i asaj lagjeje, që përfshin disa shtëpi, të trajtohet seriozisht nga ekzekutivi dhe të gjendet një zgjidhje konkrete.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Arben. Në bazë të kësaj çështjeje që e thatë ju dhe zonja Teuta, duke e bashkuar edhe me sqarimet e nënkryetarit, unë këtu në prezencë po e obligoj nënkryetarin që në mbledhjen e parë të bordit, që do të mbahet të martën e ardhshme (meqenëse e hëna është ditë pushimi), kjo çështje të diskutohet bashkë me kryetarin dhe ekzekutivin. Po ashtu, të shqyrtohet se çfarë hapa do të ndërmarrë ekzekutivi në vazhdim për zgjidhjen e këtij problemi. A pajtoheni kështu? Esat, urdhëro.

Esat Raci: Këto që i tha Teuta mund t'i dijë më mirë, pasi është banore e asaj lagjeje. Sipas informatave që kam, është kërkuar një zgjidhje në bashkëpunim me institucionet komunale dhe qeveritare, si Infracosi apo ministritë përkatëse. Ekziston mundësia që kjo çështje të zgjidhet

përmes dhënies në shfrytëzim. Qytetarët kanë të drejtë të bëjnë kërkesa për zgjidhjen e problemeve të tyre. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Esat. Urdhëro, Teuta edhe njëherë.

Teuta Mulaj: Ne si banorë kemi biseduar dhe kemi një përfaqësues të lagjes, si dhe kemi komunikuar me Infracosin. Nga ana e komunës kërkohet vetëm një kërkesë, që pastaj të mund të jepet në shfrytëzim dhe të kthehet në pronë publike. Kjo çështje po zgjat që nga viti 2024 dhe nuk ka pasur lëvizje konkrete. Mendoj që duhet të dilet në terren dhe të shihet gjendja, pasi rruga është vërtet e pakalueshme. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Teuta. Për momentin propozoj që të obligohet kryetari që në mbledhjen e ardhshme të ekzekutivit ta trajtojë këtë çështje dhe të japë një epilog. A pajtoheni? A ka dikush tjetër diçka në pikën “Të ndryshme”?
Atëherë ju falënderoj të gjithëve.

Procesmbajtësja,
Monika Palushi-Gojani



KRYESUESI,
Enver Berisha

